

Objekti: “QENDRA MULTIFUNKSIONALE E
MIRËMBAJTJES KORÇË”

RELACIONI ARKITEKTUROR

PËRGATITI: **NET-GROUP SH.P.K.**

Maj, 2020



1. Përshkrim i përgjithshëm i plansistemimit

Prona e parashikuar për zhvillimin e projektit është sistemuar në mënyrë që të përfshijë sa më poshtë:

1. Godina administrative minimum 2 kate: Sip 300 m² (gjurma)
2. Magazinë të mbuluar metalike: Sip 400 m²
3. Shesh depozitimi të jashtëm: Sip 50 m² (mbeturinash)
4. Strehë metalike 5 metra të lartë lartë Sip 200-250 m²
5. Vend parkime automjesh të gjata: Njësi 2 - 5
6. Vend parkime automjesh të vogla: Njësi 10-15
7. Rugë qarkullimi të brendshme që të lejojnë hyrjen në kompleks, aksesin në sheshe dhe daljen nga kompleksi të automjeteve të gjata plus hyrjen, parkimin dhe daljen e automjeteve të vogla.
8. Rugë hyrje, dalje dhe qarkullimi të brendshëm këmbësorësh
9. Zona të gjelbëruara/ rekreative

Sistemimi i sheshit për qarkullimin e automjeteve është kushtëzuar kryesisht nga trajektorja e parashikuar për lëvizjen dhe kthimin e automjeteve të rënda sipas standardeve AASHTO, e ilustruar dhe në figurën përkatëse.

Përroi ekzistues është trajtuar me argjinaturë në të dyja anët dhe materiali i grumbulluar prej gërmimeve është mbledhur në formë trapezoidale për mbrojtje ndaj vërshimeve të mundshme. Niveli i të gjithë sheshit është rritur me afërsisht 1 m, për shkak se zona është kënetore, dhe kjo është reflektuar dhe në themelet e strukturave të propozuara. Prona është kufizuar me mure rrethuese kryesisht me kangjella.




Figure 1. Ilustrim i trajektores së automjeteve të rënda.

2. Përshkrim i godinave

Zyrat janë një strukturë betoni 2 katëshe me plan drejtëkëndor dhe çati me pjerrësi në dy drejtime. Magazina është një strukturë metalike 1 katëshe në formë L-je e cila “mbështjell” dy prej faqeve të



godinës që shërben si zyra. Struktura është e veshur me panele sanduiç me ngjyrë gri të çelët. Midis dy godinave ka një korridor të hapur 1.7 m.



Figure 2. Pamje ilustruese e sheshit dhe godinave.

2.1. Zyrat

Kati 0 është organizuar kryesisht me hapësira për qëllime shërbimi dhe mirëmbajtjeje. Kati përfshin recepsionin dhe hapësirën e pritjes, kantinën dhe një kuzhinë për stafin, një ambient për serverin, një dhomë për pajisjet e rrjetit mekanik, një zyrë për raportuesit dhe hapësirën e tualeteve dhe ndërrimit. Kalimi për katin 1 bëhet nëpërmjet shkallëve dhe ashensorit. Kati 1 përbëhet kryesisht prej zyrave për stafin; ai përfshin gjithashtu një sallë mbledhjeje dhe një dhomë për sanitaren. Godina ka një shkallë të jashtme emergjence.

Kati 0 parashikon gjithsej:

- 1 (një) ambient për serverin
- 1 (një) dhomë teknike
- 2 (dy) ambiente (një ambient për femra dhe një për meshkuj) të dedikuara për dhoma ndërrimi të pajisura me dushe (dy dushe për cdo ambient, gjithsej katër dushe) dhe tualete
- 1 (një) kantinë
- 1 (një) zyrë për raportuesit.

Kati 1 parashikon gjithsej:

- 1 (një) zyrë për përgjegjësin e zyrës (manager – in e zyrës)
- 3 (tre) zyra për sistemimin e stafit dhe kryerjen e funksioneve administrative
- 1 (një) ambient fjetjeje për sanitaren + 1 (një) tualet
- 1 (një) sallë mbledhjeje
- 3 (tre) për katin.



KATI 0




Figure 3. Planimetri e katit 0 të zyrave dhe magazinës.

KATI 1




Figure 4. Planimetri e katit 1 të zyrave.



2.2. Magazina

Magazina është një strukturë metalike në formë L-je; në njërin krah të saj janë pozicionuar 2 laboratorët, ndërsa krahun më të gjatë, i cili është i parashikuar për kalimin e automjeteve, hapësira është lënë e lirë. Në të dyja anët e korsiës qendrore është përcaktuar kalimi i këmbësorëve me sinjalistikë horizontale. Magazina është një katëshe me çati me pjerrësi 10%. Hyrja dhe dalja e automjeteve është e lehtësuar nga prania e rampave.

Magazina përfshin gjithsej:

- 2 (dy) laboratorë (një instrumental dhe një mekanik) së bashku me dushet përkatëse
- 1 (një) hapësirë tranzitore si hyrje për në laboratore
- 1 (një) hapësirë për transportin dhe magazinimin e materialeve.

KATI 0




Figure 5. Planimetri e katit 0 të magazinës.

